

F.3 ISSN

Baza e ISSN-së ndodhet në serverin e IZUM-it dhe përditësohet një herë në ditë. Regjistrimet janë në formatin MARC 21.

F.3.1 Dritarja për kërkim

Dritarja për kërkim e bazës së ISSN-së është e ngjashme me dritaren për kërkim të regjistrimeve bibliografike në formatin COMARC/B. Në pjesën e sipërme të dritares për kërkim mungon butoni për të kaluar kërkimin nga baza lokale e të dhënave në COBIB, fusha për klasifikimin e rezultateve të kërkimit, butoni për përzgjedhjen e operatorëve shtesë, butoni për ruajtjen e kriterëve të shënuara për kërkim dhe fushat për kufizimin shtesë të kërkimit. Në pjesën e poshtme të dritares për kërkim mungon vetëm fusha për ndryshimin e formatit të rezultateve të kërkimit dhe ajo për zgjedhjen e pyetjeve për kërkim, të cilat janë ruajtur paraprakisht.

Në disponim janë këto fusha për kërkim:

- ISSN
- Titulli kyç
- Titulli
- Botuesi
- Vendi i botimit
- Viti i fillimit
- Viti i fundit
- Prodhuesi
- Titujt e lidhur
- ISSN-të e lidhura
- Shteti
- Gjuha
- ISSN-L
- Kodi i qendrës kombëtare të ISSN-së
- Statusi i botimit
- Lloji i burimit në vazhdim
- Periodiciteti
- Kodi i mjedisit
- KDU
- Titulli kyç i shkurtuar

F.3.2 Paraqitësi

Në paraqitës janë tre skeda, të cilat mundësojnë shfaqjen e regjistrimit në tri formate: **Formatin bazë**, **MARC** dhe **MARC origjinal**.

F.3.2.1 Formati bazë

Në formatin bazë shfaqen këto attribute dhe vlerat e tyre, nëse ekzistojnë:

- ISSN
- titulli kyç
- botuesi
- vendi i botimit
- viti i botimit
- prodhuesi
- numërtimi
- periodiciteti
- shteti
- gjuha
- ISSN-L
- kodi i qendrës kombëtare të ISSN-së
- KDU
- titulli kyç i shkurtuar
- titulli
- titujt e lidhur

F.3.2.2 Formati MARC

Në skedë shfaqet kopja e regjistrimit nga formati MARC 21 në formatin COMARC/B.

F.3.2.3 Formati MARC origjinal

Në skedë shfaqet regjistrimi në formatin MARC 21.

F.3.3 Kujtesa e fragmenteve e regjistrimeve

Metodat për regjistrimet në bazën e të dhënave të ISSN-së në kujtesën e fragmenteve të regjistrimeve funksionojnë ngjashëm si te regjistrimet nga baza lokale e të dhënave dhe nga COBIB-i.

Për të shfaqur regjistrimin në formatin MARC 21 përdorim metodën **Kujtesa e fragmenteve / Shfaq në formatin origjinal**. Nëse regjistrimin në formatin MARC 21 dëshironi ta printoni, pas metodës **Kujtesa e fragmenteve / Shfaq në formatin origjinal** zgjedhni edhe metodën **Kujtesa e fragmenteve / Printo regjistrimin**.



Shënim:

*Metoda **Kujtesa e fragmenteve / Përgatit regjistrimet për printim** nuk është aktive, nëse në kujtesën e fragmenteve është përzgjedhur regjistrimi nga baza e të dhënave të ISSN-së ose nga ndonjë bazë tjetër e huaj e të dhënave.*